



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 10.04.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Mungoi: Glauk Konjufca.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gresa Ramadani, Lëvizja Vetëvendosje; Besiana Dauti dhe Galdin Vagangjiu Ekonomia Online; Arben Restelica, Klan KOSOVA; Rreze Hoxha, GLPS; Ardian Bajraktari, MD; Agim Maraj, British Embassy; Rinor Beka, NDI; Albert Krasniqi, KDI; Amire Qamili BIRN dhe Edita Kusari, EUSR/EV.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë me kandidatët për drejtor dhe zëvendës-drejtor të Sekretariatit ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime për të diskutuar në pikën të ndryshme për projektligjin për Amnisti dhe Projektligjin për Ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim.

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë me kandidatët për drejtor dhe zëvendës drejtor të Sekretariatit ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Kryetarja paraqiti propozim-vendimin e Qeverisë me kandidatët për drejtor dhe zëvendës drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës duke i përmendur emrat e tyre dhe njëkohësisht kishte vërejtje për Qeverinë e cila ka propozuar z. Naser Shala, ku znj. Haxhiu paraqiti dyshime që ky person është i përfshirë në përgjimet e aferës ‘Pronto’. Ndërkaq tha se nëse është kështu ky pozicion është shumë i rëndësishëm dhe për pozicione të tilla Qeveria ka propozuar njerëz që nuk kanë asnjë integritet moral dhe që janë të përfshirë në përgjimet e fundit, ndaj të cilëve u ngritën edhe disa aktakuza duke pohuar se është e papranueshme të dërgojmë njerëz të tillë, që mund të përkeqësojnë edhe punën në këtë Agjenci.

Shkumbin Demaliaj tha se këto propozime kanë kaluar disa procedura derisa kanë ardhur këtu. Z. Demaliaj shtoi se sa i përket kontributit tij në luftë, ka një të kaluar të begatshme duke qenë një prej udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën ku ka vepruar dhe për çështjet tjera që u folën i përket prokurorisë dhe gjykatës të merret me këtë çështje. Ndaj z. Naser Shala për mua është një person me integritet të lartë dhe sikurse çdo qytetar i Kosovës që ka të drejtë të aplikojë në bazë të përgatitjes shkollore që e ka.

Bilall Sherifi tha se do ishte mirë që ne të vendosim nga aspekti ligjor, nëse i plotësojnë kushtet propozimet që kanë ardhur nga Qeveria dhe më pas t’i procedojmë për Kuvend. Ndërkaq potencoi faktin se duhet të përmbahemi për të folur në aspektin moral sepse nuk mund të dimë se cili është standardi për moralin, duke mos debatuar për këtë çështje.

Kryetarja, sqaroi se ka respekt për çdo ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për atë që kanë bërë gjatë luftës, por nuk ka asnjë respekt ndaj atyre që kanë keqpërdorur dhe shfrytëzuar, për t’u pasuruar pas luftës.

Shkumbin Demaliaj, në fjalën e tij të sërishme potencoi faktin se këtu jemi për të vendosur në aspektin ligjor dhe jo të merremi me integritetin apo figurën e personave, ndaj propozoi që të procedohen për Kuvend dhe aty të vendosë seanca.

Korab Sejdiu, tha se nga këto propozime për drejtor të sekretariatit ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës më e përshtatshme është znj. Florie Kika e cila e ka edhe përgatitjen shkollore me profesion juriste. Ndërkaq tha se kryesisht kandidatët e propozuar për

Agjenci nuk po na vijnë më të mirë sepse pothuajse shumica janë të dërguar nga politika duke i lënë njerëzit më të mirë profesionalisht ku fatkeqësisht po mbesin jashtë.

Nezir Çoçaj tha se nuk do ishte mirë që të përmbahemi në deklarime të tilla sepse ne vërtet jemi Komision për Legjislacion, por nuk jemi gjyqtarë dhe secili nga personat e ka një vlerë në shoqëri. Në bazë të biografisë z. Shala i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e parapara dhe është mirë që ne duhet këtë propozim ta dërgojmë në seancë.

Arben Gashi tha se nëse ka vërejtje që kandidatët nuk i plotësojnë kriteret apo kushtet nga përvoja e punës, ne mund t'i rekomandojmë seancës për apo mos miratim dhe seanca është ajo që vendos.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, **me katër vota për**, (Bilall Sherifi, Bahrim Shabani, Shkumbin Demaliaj dhe Nezir Çoçaj), **katër vota kundër** (Albulena Haxhiu, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu dhe Arben Gashi) **dhe një votë abstenim** (Igor Simic) nxori këtë:

Rekomandim

1. Të mos emërohen për drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës kandidatët e propozuar;
 - **Florije Kika**
 - **Naser Shala**
2. Të mos emërohen për zëvendës drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës kandidatët e propozuar:
 - **Milaim Çekaj**
 - **Mark Buzhala**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve**

Kryetarja paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 06/L për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe tha se do duhej të forcohej zyra për zyra e Prokurorit disiplinor dhe jo t'i lihet në kompetencë KGJK-së dhe KPK-së sipas propozimit që ka ardhur në projektligj. Mendoj se do jetë shumë problem nëse ne e lëmë, që të merren KGJK dhe KPK me shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sepse për shkak të raporteve miqësore ndërmjet tyre ndoshta këto shkelje nuk do të adresoheshin. Po ashtu është i papranueshëm edhe roli që ka marrë Ministria e Drejtësisë ku personi fizik ankesën ndaj një gjyqtari dhe një prokurori duhet ta adresojë te Ministria e Drejtësisë dhe më pas kjo e fundit e adreson në KGJK apo KPK. Në fund z. Haxhiu tha se jam kundër këtij projektligji duke pohuar se nuk duhet shuar Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe këto kompetenca t'i marrë KGJK dhe KPK dhe ftoi anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Korab Sejdiu tha se Zyra e Prokurorit Disiplinor ka qenë një dështim dhe kjo jo për mungesë të investimeve, por për shkak të personit që ka udhëhequr këtë zyrë, i cili nuk i ka kryer detyrat e tij me përkushtimin e duhur. Kështu që ne, si deputet, duhet të vendosim a do duam të ndërrojmë në tërësi qasjen apo do të duam ta lëmë këtë institucion, kështu siç është, por vetëm të sigurohemi që në udhëheqjen e këtij institucioni të vijmë persona adekuat, që e marrin shumë seriozisht punën e tyre. Në çdo projektligj që po vjen ka një tentativë të Ministrisë së Drejtësisë të ndërhyjë nga ekzekutivi në punët e gjyqësorit dhe mendoj se kjo rrugë është gabueshme, sepse qëllimi ynë nuk është që ekzekutivi të ndërhyjë në punët e gjyqësorit, por është fuqizimi i gjyqësorit përmes zgjidhjes së problemeve që ata kanë.

Sami Kurteshi tha se shuarja e zyrës së Prokurorit Disiplinor është shumë e rëndë sepse një organ, që ka bërë përpjekje që të luajë një rol në këtë drejtim e kanë eliminuar. Qëllimi i ligjit nuk është disiplinimi apo përgjegjësia, por në të vërtetë heqja e tyre. Ndërkaq tha se do duhej të krijohet një organ i pavarur, që të ketë edhe përfaqësues të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokuroria dhe natyrisht edhe persona të tjerë të përgatitur mirë profesionalisht të cilët vijnë jashtë fushës së gjyqësorit në mënyrë që t'i trajtojnë këto çështje. Ndër të tjera z. Kurteshi paraqiti një sërë vërejtjesh përmbajtjesore, strukturore teknike dhe gjuhësore të projektligjit dhe tha se nuk do duhet të përkrahet pa u marrë edhe një herë në shqyrtim ky projektligj.

Hajdar Beqa konsideroi se projektligji i plotëson kushtet për miratim në parim pavarësisht vërejtjeve eventuale që mund të jenë në aspektin përmbajtjesor dhe gjuhësor. Më tej tha se ky projektligj është i rëndësishëm së veçantë kur bëhet fjalë për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke pohuar se mes dy leximeve, ne do të ftojme edhe palët e interesit të cilët do të japin kontributin e tyre, ndaj ne duhet ta votojmë dhe procedojmë këtë projektligj për Kuvend.

Bilall Sherifi pati vërejtje për Ministrinë e Drejtësisë që të ketë kujdes kur procedon projektligje në Kuvend, sepse Grupet e Punës që formohen nga ne nuk janë Grupe Hartuese duke e ditur që kjo nuk është detyra jonë e vetme, por kemi edhe detyra të tjera, ndaj mos t'i mbetet barra Grupit të Punës për Projektligjin për t'u shndërruar në Grup Hartues.

Shkumbin Demaliaj tha se nëse projektligji është me shumë gabime përmbajtjesore dhe gjuhësore propozojmë që ta kthejmë në mënyrë që të punohet një projektligj i mirë, duke parë rëndësinë se çfarë rregullon ky projektligj.

Kryetarja sqaroi se mandatin e kaluar është diskutuar që të procedohet në Kuvend një projektligj për të fuqizuar Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe propozimi tjetër ka qenë që Ministria e Drejtësisë të jetë institucioni ku do të raportohet për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve apo prokurorëve e cila në atë kohë u kundërshtua nga Shoqëria Civile dhe partia Vetëvendosje.

Arben Gashi tha se çështja është se a duhet Ministria e Drejtësisë të ketë ndikim te prokurorët dhe gjyqtarët dhe a konsiderohet ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit, kur kemi këtë koncept të organizimit dhe cila është pasoja që prodhojmë në një Qeveri hipotetike e cila do të ketë tendencë të disiplinimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Ne mund të krijojmë këtë lloj mekanizmi realisht dhe potencialisht të rrezikshëm dhe si ideologji duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit të institucioneve tona dhe vullnetin e tejshtafur politik për ndërhyrje të rasteve, por dhe çështjeve të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Në fund z. Gashi tha se duhet të japim rekomandim negativ dhe t'i

kthehet propozuesit me vërejtje për çështje substanciale dhe me vërejtje për çështje teknike edukuese.

Hajdar Beqa tha se këtu po jepen interpretime të njëanshme, ndërsa në grupin e punës ne do të dëgjojmë të gjitha palët e interesit në lidhje me këtë projektligj duke diskutuar për secilin nen veç e veç dhe të shohim edhe qëllimin e sponsoruesit, por mos të bëjmë politikë për secilin projektligj.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me 5 vota për, të z. Hajdar Beqa, Nezir Çoçaj, Shkumbin Demaliaj, Bahrim Shabani dhe z. Bilall Sherifi, ndërsa 5 vota kundër ish-in Albulena Haxhiu, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu dhe Igor Simic, nxori këtë:

Rekomandim

1. Të mos miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

4. Të ndryshme

A. Diskutim në lidhje për Projektligjin nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim

Kryetarja tha se projektligjin për Marrëveshjen nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim e kemi diskutuar mbledhjen e kaluar, por problemi qëndron se i njëjti në seancë votohet me 2/3 e votave, sepse është Marrëveshje Ndërkombëtare, ndërsa në komision këto Marrëveshje po votohen me shumicën e thjeshtë dhe pas një takimi me administratën e Kuvendit më është sugjeruar që ta rikthej sërish për shkak se duhen 2/3 e anëtarëve të komisionit që të përkrahet ky projektligj dhe do ishte mirë që të krijojmë një standard në këtë drejtim. Po i njëjti problem është edhe për projektligjin për amnisti sepse edhe ky projektligj është votuar me shumicë të thjeshtë.

Arben Gashi tha se kur komisioni merr një vendim atë e hedh poshtë vetëm seanca dhe jo komisioni duke pohuar se paraqet precedent të rrezikshëm për raste të tjera.

Në lidhje me këtë çështje anëtarët e komisionit potencuan se në të ardhmen shndërrohen në precedent dhe meqenëse kjo pikë është hedhur në votim mbledhjen e kaluar, të konstatohet gjendja faktike sepse votat ekzistojnë. Ndërkaq nga anëtarët e Komisionit u konstatua që të procedohet me rekomandim për mos miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu